

Numri: 04 ~ 04/2016



Balkan PERSPECTIVES

Revistë për ballafaqimin me të kaluarën

ÇFARË ËSHTË DEJTONI PËR NE?

..... 14


**MARRËVESHJET E BRUKSELIT
- PROGRES APO PROCES?**

..... 20



Letrat për paqe

03. KRYEARTIKULL	NDALOI KONFLIKTIN, POR JO INCIDENTET NDËRETNIKE - MARRËVESHJA E OHRIT DËSHTOI, PASI U PËRDOR PËR INTERESA POLITIKE	16.
04. VOX POP		
06. NË LIDHJE ME MARRËVESHJET PËR PAQE – NJË PREZANTIM I SHKURTËR	VLADO POPOVSKI: MUNGON PROMOVIMI POZITIV PËR MARRËVESHJEN KORNIZË TË OHRIT NË MËNYRË QË TË TEJKALOHET MOSBESIMI	18.
08. RAMBUJE: LUFTA SI VAZHDIMËSI E POLITIKËS		
10. MARRËVESHJA PËR PAQE E DEJTONIT NË KRYETITUJT E PORTALEVE TË LAJMEVE DHE NË SHTYPIN E BOSNJE E HERCEGOVINËS	MARRËVESHJET E BRUKSELIT - PROGRES APO PROCES?	20.
	LAJME DHE PËRDITËSIME	23.
14. ÇFARË ËSHTË DEJTONI PËR NE?	IMPRESSUM	24.





KRYE-ARTIKULL

Të dashur lexues,

Ballafaqimi me të kaluarën është një temë e gjerë dhe përmban shumë procese përmes të cilave mund të kalojë një shoqëri kur merret me dhunën dhe represionin politik të së kaluarës. Në botimet tona të mëparshme, ne kemi eksploruar tema abstrakte dhe emocionuese, si kujtimi i së kaluarës, përkujtimi i heronjve të njohur dhe të panjohur dhe se si të mbijetuarit i trajtojnë traumat e tyre.

Këtë herë, botimin më të ri të Balkan Perspectives ia kemi përkushtuar çështjes më teknike dhe politike të marrëveshjeve për paqe. Kjo nuk do të thotë se kjo temë më racionale ka më pak rëndësi. Marrëveshjet për paqe hedhin themelet e gjithçkaje që vjen pas luftës. Ato janë rezultatet e diplomacisë dhe shpeshherë marrin forma të ndryshme. Disa marrëveshje për paqe thjesht e ndërpresin dhunën, ndërsa disa të tjera përcaktojnë udhëzues të qartë për periudhën e pas-luftës dhe sjellin reforma institucionale.

Pas trazirave të viteve '90, skena politike e Ballkanit Perëndimor është formësuar nga disa marrëveshje për paqe dhe negociata diplomatike. Në këtë botim ne paraqesim dhe diskutojmë disa prej tyre.

Së pari, kemi Marrëveshjen e Dejtonit, marrëveshja për paqe që i dha fund Luftës së Bosnjes. Për Dejtonin është folur shumë. Në vend se ta vazhdojmë diskutimin edhe më tutje, ne sjellim zërat e ndryshëm që kanë mbizotëruar në median e Bosnjes e Herecegovinës me rastin e 20 vjetorit të marrëveshjes në vitin 2015. Kryetitujt e ndryshëm tregojnë qartë se opinionet janë të ndryshme dhe se ende mungon një version përfundimtar për Marrëveshjen e Dejtonit.

Diplomacia ndërkombëtare rreth shteteve ballkanike në luftë vazhdoi në vitet 1990. Negociatat e radhës u zhvilluan në

Rambuje në vitin 1999 ndërmjet Republikës Federale të Jugosllavisë dhe një delegacioni të shqiptarëve nga Kosova. Marrëveshja e hartuar nga NATO-ja nuk u pranua në fund nga delegacioni jugosllav dhe kjo gjë çoi në bombardimin e Jugosllavisë nga NATO. Negociatat dhe rezultatet e tyre ende kontestohen. Julijana Mojsilović na kthen mbrapa në kohë dhe na bën t'i rijetojmë negociatat.


Vetëm dy vite më pas, i takoi Maqedonisë të nënshkruajë marrëveshje. Marrëveshja Kornizë e Ohrit u nënshkrua ndërmjet qeverisë së Maqedonisë dhe përfaqësuesve të shqiptarëve nga Maqedonia, duke i dhënë fund dhunës ndërmjet dy palëve. Ne shtjellojmë se si shihet sot marrëveshja nga përfaqësuesit e shoqërisë civile në Maqedoni. Po ashtu, kemi intervistuar Vlado Popovskin, i cili ka marrë pjesë në negociata dhe na jep informata të dorës së parë për procesin e atëhershëm.

Negociatat vazhdojnë dhe sot e kësaj dite, ndërkohë që vazhdojnë bisedimet ndërmjet Serbisë dhe Kosovës në Bruksel. Edhe pse këto diskutime nuk duhet të shihen si marrëveshje për paqe, ato i kontribuojnë normalizimit të marrëdhënieve mes Serbisë e Kosovës. Analiza jonë për negociatat, e shkruar nga Andreas Berg, është disi pesimiste sa i përket procesit të ballafaqimit me të kaluarën nga të dy kombet, por i vlerëson bisedimet si hapi i parë në një proces të gjatë drejt paqes.

Shpresojmë se do t'ju pëlqejë leximi i këtij botimi të Balkan Perspectives!

*Singerisht,
Maïke Dafeld/ Kryeredaktore*

A besoni në Marrëveshjen për Paqe?



Bosnja dhe Hercegovina

Unë besoj se Marrëveshja për Paqe në Bosnje e Hercegovinë nuk e ka arsytuar plotësisht qëllimin e saj, sepse nuk ka sjellë prosperitet për shtetin apo stabilitet publik e politik. Sidoqoftë, Marrëveshja për Paqe ka sjellë një „epokë“ të re në historinë e Bosnje e Hercegovinës që të paktën ka arritur një lloj shtetësie, ndërsa luftës i ka ardhur fundi. Njëzet vjet pas nënshkrimit të Marrëveshjes për Paqe, qytetarët e Bosnje e Hercegovinës ende jetojnë në „epokën e pasluftës“, në një shtet që dukshëm është rrugës drejt prosperitetit.

Božana P., 37

Sipas pikëpamjes sime, ajo e një fëmije që ishte i lumtur të shihte arritjen e Marrëveshjes për Paqe të Dejtonit dhe përfundimin e luftës në Bosnje e Hercegovinë, marrëveshjet paqësore janë një mjet i shkëlqyer për të ndalur konfliktet dhe për të parandaluar dëmet e mëtejshme. Meqë në shumicën e rasteve marrëveshja është zgjidhje formale për ndaljen e konfliktit, mendoj se marrëveshjet për paqe mund të përmirësohen vetëm me anë të përpjekjeve qenësore të vendimmarrësve për zgjidhje afatgjata drejt arritjes së mirëqenies së vërtetë për palët e përfshira në konflikt.

Belma P., 32

Për të keq, unë nuk besoj në marrëveshjet për paqe, sepse marrëveshjet për të cilat kam njohuri në Bosnje e Hercegovinë, kryesisht janë imponuar nga jashtë. Mendoj se marrëveshja është vetëm një zgjidhje e përkohshme e cila vetëm se i mban pezull problemet që janë përshkallëzuar në një shoqëri, pavarësisht se të cilës natyrë kanë. Nëse një shoqëri dështon të zgjidhë mosmarrëveshjet shekullore dhe nuk mund të arrijë pajtimin, atëherë marrëveshja për paqe është veçse një copë letër dhe do të shkelet herët apo vonë.

Amela M., 28

Maqedonia

Nuk e kam vështirë të besoj në marrëveshjet e paqes. Kjo për faktin se historia na mëson për to. Le ta marrim për shembull Marrëveshjen e Ohrit. Ajo i dha fund konfliktit të armatosur duke i dhënë mundësi dialogut politik që të sjellë paqen.

Elham B., 29

Po, unë besoj në marrëveshjet e paqes, por që marrëveshjet e tilla të mbijetojnë dhe të vendosin paqen, duhet të përmbushen shumë kushte. Së pari, duhet të adresohet konflikti dhe marrëveshjet duhet të pranohen nga shoqëria. Në të kundërtën, ato marrëveshje që sillen nga jashtë, nuk do ta arrijnë qëllimin e tyre që është rivendosja e paqes dhe mundësia për një shoqëri më të mirë në të ardhmen.

Danijela Z., 23

Në fakt, kjo është një pyetje mjaft e ndërlikuar, sepse marrëveshjet e paqes janë marrëveshje të nënshkruara nga qeveritë dhe jo nga popujt. Pra, nëse qeveria është zgjedhur në mënyrë demokratike dhe përfaqëson dëshirat e shumicës së popullit në shtet dhe nëse supozojmë se ato dy apo më shumë qeveri do ta respektojnë atë marrëveshje, atëherë PO, mendoj se ato qëndrojnë për diçka, funksionojnë dhe arrijnë një qëllim të caktuar.

Ana-Marija K., 25

Kosova

“Nuk besoj në marrëveshjet për paqe, sepse mendoj që ato marrëveshje janë arritur përmes mënyrave ligjore dhe janë rregulla të shkruara. Marrëveshjet reale, të cilat mendoj se duhet të bëhen për të arritur paqen, kanë të bëjnë me bashkëpunimin dhe solidaritetin ndërmjet dy popujve ose grupeve specifike brenda një populli. Kjo nënkupton bashkëpunimin, harmonizimin e interesave dhe shmangien e konflikteve apo çështjeve të tjera që çojnë drejt rëndimit të raporteve të këqija dhe konfliktit. Ndaj, nuk besoj në marrëveshjet për paqe nëse ato nuk janë rezultat i mobilizimit qytetar dhe shtetëror. Dhe nuk besoj në marrëveshje që nënshkruhen dhe pastaj mbesin në sirtarë.

Albulena N., 26

Është shumë vështirë të besohet se këto marrëveshje, që nënshkruhen nga dikush dhe përfaqësojnë një shtet, mund të zbatohen në jetën reale. Natyrisht, si ide, janë mënyra më paqësore për t'i dhënë fund luftës. Por përmbajtja e këtyre marrëveshjeve është gjithmonë një mister. Për shembull, marrëveshja për paqe ndërmjet Kosovës e Serbisë. Marrëveshjet e vërteta nuk janë publikuar asnjëherë. Të vetmet gjëra që bëhen publike janë ato kur mendohet se do të nisë zbatimin e marrëveshjeve, por dy vite pas nënshkrimit të tyre ende nuk kemi ndonjë konkluzion se për çfarë janë pajtuar palët në të vërtetë apo si i kanë ndihmuar Kosovën e Serbinë të zhvillohen dhe të ecin në drejtim të Bashkimit Evropian. Ndaj, është shumë vështirë të besohet në marrëveshjet për paqe. Është një koncept i gjerë.

Ramadan S., 21

Marrëveshjet për paqe janë mënyra më e mirë; unë vërtetë besoj në to. Sidoqoftë, bëhet e vështirë kur flasim për rajonin. Ende nuk ka ardhur koha, por shpresoj se do të kemi marrëveshje për paqe në të ardhmen, sidomos me Serbinë.

Kushtrim L., 32

Serbia

Pjesërisht [besoj në to], por varet se deri në çfarë mase janë të civilizuara shtetet që arrijnë një marrëveshje.

Mara A., 24

Jo më. Marrëveshjet që kanë hyrë në fuqi pas Luftës së Parë dhe të Dytë Botërore janë ndryshe. Ato marrëveshje kanë hyrë në fuqi në mes të disa shteteve dhe pjesës së mbetur të botës dhe ka qenë e pamundur të mos i respektoje. Marrëveshjet e sotme nuk e kanë më atë rëndësi.

Jagoda N., 64

Nuk besoj aspak në to. Nëse pala nënshkruese merr mbështetjen e një fuqie të madhe, atëherë nis lufta për më shumë të drejta se sa ato që janë definuar në marrëveshje. Nga ana tjetër, kur kushtet bëhen më të favorshme për njërin nga palët nënshkruese, atëherë tejkalohe kufijtë dhe marrëveshja shkelet.

Aleksandar M., 38

Në lidhje me marrëveshjet për paqe – një prezantim i shkurtër



Programi i të Dhënave për Konflike i Universitetit të Upsalas (UCDP) ka regjistruar 40 konflikte të armatosura në vitin 2014. Kjo shënon një rritje prej shtatë konfliktesh në krahasim me vitin 2013 dhe numrin më të madh të konflikteve të regjistruara që nga viti 1999. Njëmbëdhjetë nga këto konflikte janë definuar si luftëra, katër më shumë se në vitin paraprak. Megjithatë, në krahasim me luftërat ndërshtetërore të shekullit të njëzetë, numri i vdekjeve më 2014 ka qenë relativisht i vogël, ndërsa janë nënshkruar dhjetë marrëveshje të paqes më shumë se në vitin paraprak. Kjo rritje e marrëveshjeve të paqes është pjesë e një trendi në rritje që nga viti 2011. Sidoqoftë, është e rëndësishme të theksohet se disa procese të paqes kanë mbetur të brishta deri në përfundim të vitit.

Procesi i paqes është një marrëveshje ku një ose më shumë palë të përfshira në konflikt pajtohen për të nisur një proces që t'i tejkalojnë dallimet. Kur bëhet fjalë për marrëveshjet e paqes, duhet të adresohen një varg çështjesh që ato të bëhen më të suksesshme. Vëmendje e posaçme duhet t'i kushtohet krijimit të një administrate të re, sistemi gjyqësor e policor, verifikimit të ushtarëve të dikurshëm, trajtimit të krimeve të luftës dhe kriminelëve të luftës, ndërtimit të paqes, adresimit të çështjes së kujdesit për refugjatët, si dhe krijimit të institucioneve shtetërore. Ne poashtu duhet të mbajmë parasysh se secila luftë dhe secili konflikt dallon nga tjetri dhe se marrëveshjet për paqe duhet t'i përshtaten secilit rast individualisht.

Sipas Erwin A. Schmidl, një nga vështirësitë kryesore në operacionet e paqes është mungesa potenciale e përkushtimit afatgjatë. Ballkani është një shembull i mirë ku vetëm përkushtimi afatgjatë mund të çojë drejt daljes nga status quo-ja. Për këtë arsye, në shumë raste bëhet e vështirë që të dihet nëse do të jenë të suksesshme operacionet paqësore. Është e vështirë të matet [ky sukses] dhe ai mund të ekzaminohet vetëm pas një periudhe kohore prej disa dekadash. Megjithatë, siç do të shihet më vonë, disa marrëveshje të bëra në Ballkan e kanë përmbushur qëllimin e tyre fillestar, por tani atyre u duhen modifikimet dhe rikonstruktimi.

Marrëveshjet e paqes janë kontrata të krijuara për t'i dhënë fund konfliktit të dhunshëm apo luftës, ose të paktën ndryshimit të tyre, në mënyrë që në një fazë të mëvonshme të trajtohen si duhet. Ka një sërë marrëveshjesh që mund të lidhen gjatë procesit të paqes. Kombet e Bashkuara përdorin këtë klasifikim: Armëpushimi, Ndërprerja e Armiqësive, Armëpushimi dhe Marrëveshjet e Armëpushimit, Marrëveshjet Paraprake, Marrëveshjet Para-Negociuese, Korniza dhe Marrëveshjet Gjithëpërfshirëse, Marrëveshjet e Përkohshme dhe Nën-Marrëveshjet.

Armëpushimi i referohet procesit gjatë të cilit palët nisin bisedimet, por ai nuk nënkupton paqen. Ndërprerja e armiçësive është ndërprerja e përkohshme e dhunës, zakonisht në fillim të procesit paqësor. Armëpushimi zbatohet në kuadër të vetë procesit të paqes dhe është pjesë e një zgjidhjeje më të zgjeruar të negociatave. Ai garanton mjaft hapësirë për negociata dhe ndihmë

- humanitare, por nuk zgjidh shkakun kryesor të konfliktit. Kur ndodh në fund të një konflikti, ai zakonisht përfshin tërheqjen e trupave, çarmatosjen dhe demobilizimin e luftëtarëve. Ai gjithashtu bëhet pjesë përbërëse e procesit paqësor. Armëpushimi tregon se pjesëmarrësit janë pajtuar të ndalin luftimet në mënyrë të përhershme.

Marrëveshjet Paraprake shërbejnë për të ndërtuar besimin ndërmjet pjesëmarrësve dhe për të krijuar bazën për nisjen e procesit të paqes. Marrëveshjet Para-Negociuese strukturojnë negociatat për t'i mbajtur ato në shtegun e duhur, për të ndihmuar që përfundimisht të arrihet qëllimi i dhënies fund të konfliktit. Marrëveshjet Kornizë zakonisht pasohen nga negociatat e gjata që përfundojnë në anekse dhe protokolle të ndara, që përmbajnë hollësitë e negociatave.

Marrëveshjet e Përgjithshme nënvizojnë çështjen kontestuese dhe lidhen zakonisht me një duarshtrengim. Ato marrëveshje kërkojnë interesin e përbashkët të të gjitha palëve në konflikt. Marrëveshjet e Përkohshme u përkujtojnë palëve që të vazhdojnë procesin e paqes dhe të përpiqen të rifillojnë negociatat e ndërprera në rast nevojë. Sidoqoftë, këto marrëveshje duhet të pasohen nga negociatat mbi çështjet themelore. Nën-Marrëveshjet ose Protokollat janë zakonisht pjesë e një marrëveshjeje më të gjerë dhe më gjithpërfshirëse. Ato shërbejnë për të adresuar më në hollësi çështjen për të cilën bëhet fjalë dhe kanë përmbajtje më të madhe teknike se sa marrëveshjet kornizë.

Marrëveshjet mund të ndihmojnë në arritjen e paqes përmes zbatimit të mekanizmave që përmirësojnë kapacitetet e monitorimit dhe shpërblejnë sjelljen bashkëpunuese. Sidoqoftë, fuqitë e tyre qëndrojnë në komponentët më specifikë si demilitarizimi i zonave, kontrolli i armëve dhe marrja e masave për ndërtimin e besimit.

Mirëpo kur u hedhim një sy shteteve të Ballkanit dhe marrëveshjeve si Marrëveshja për Paqe e Dejtonit Marrëveshja e Ohrit apo Marrëveshja Erdut, ne ballafaqohemi me komplikime të mëtejme. Shtetet e Ballkanit që kanë lidhur këto marrëveshje vuajnë nga një shkallë e lartë e jostabilitetit ekonomik dhe politik. Kjo vjen si rezultat i një sërë faktorësh, përfshirë zbatimin jo të plotë apo të pjesshëm të reformave në sistemin ekonomik, procesin jo të plotë të demokratizimit, mungesën e shërbyesve civilë të trajnuar dhe shërbyesve të tjerë shtetërorë, që shkaktohet nga largimi i trurit drejt Perëndimit, nivelin e lartë të korrupsionit dhe krimin e organizuar, si nga dhe komunitetet e shoqërisë civile të pazhvilluar.

Për më tepër, përfshirja e mëhershme e organizatave ndërkombëtare ka rritur varësinë e akterëve lokalë ndaj bashkësisë ndërkombëtare. Siç thekson me të drejtë Stefan Wolff: "institucionet e krijuara përmes ndërmjetësimit ndërkombëtar dhe në disa raste, përmes presionit të dukshëm ndërkombëtar, siç ka ndodhur gjatë negociatave për Marrëveshjen e Dejtonit, zakonisht kanë mungesë të fleksibilitetit, legjitimitetit demokratik dhe efikasitetit dhe për këtë arsye, zakonisht kanë mbështetje të ulët nga vendorët".

Nuk mund ta mohojmë nevojën e planeve për paqe dhe programeve për stabilitet siç janë Akordet për Paqe të Dejtonit apo Marrëveshja Kornizë e Ohrit. Kornizat politike kanë potencialin të arrijnë ujdi për të normalizuar marrëdhëniet ndërmjet palëve të dikurshme në konflikt. Në gjithashtu mund të pajtohemi se planet për paqe e kanë përmbushur qëllimin e tyre kryesor: parandalimin e shpërthimit të konflikteve të reja të dhunshme. Rimëkëmbja pas konfliktit është proces i ndërlikuar dhe i gjatë. Procesi i krijimit të kombit dhe krijimit të shtetit nuk ka përfunduar ende në Bosnjë e Hercegovinë, e as në Kosovë. Edhe pse gjasat janë të ulëta që të shfaqen luftëra të reja si pasojë e mospërfundimit të procesit të shtet-ndërtimit, shumica e shteteve të Ballkanit janë larg pajtimit.

Qëllimi final duhet të jetë arritja e një situatë ku të gjitha palët janë fituese. Një mënyrë e mundshme do të ishte kushtëzimi për anëtarësim në BE nga vet blloku, gjë që do të detyronte publikun e përgjithshëm dhe elitat politike të bëjnë kompromise për të arritur atë për të cilën shumica beson se do të zgjidhte problemet aktuale. Disa mësimë mund të merren nga procesi i stabilizimit në Maqedoni, në Slloveninë Lindore, Kroaci, edhe pse secili rast ka specifikat e veta historike, politike dhe sociale.

Nerkez Opačin

është ligjërues dhe koordinator i shkollës verore të Universitetit Ndërkombëtar të Sarajevës. Fushat e tij për hulumtim përfshijnë analizat dhe zgjidhjet e konfliktit, studimet e paqes, edukimin për paqe, ballafaqimin me të kaluarën, pajtimin ndëretnik, drejtësinë tranzicionale dhe marrëdhëniet ndërkombëtare

RAMBUJE: LUFTA SI VAZHDIMËSI E POLITIKËS

Pesë muaj pas kërcënimit të parë për bombardime kundër Republikës Federale të Jugosllavisë, e cila atëkohë përbëhej nga Serbia dhe Mali i Zi, delegacioni i NATO-s arriti një lloj marrëveshjeje me ushtrinë jugosllave dhe zyrtarët politikë të Shtabit të Përbashkët të Ushtrisë Kombëtare Jugosllave (YNA). Siç u kuptua më vonë, kjo nënkuptonte vetëm shtyrjen e të pashmangshmes. Marrëveshja implikonte një tërheqje të pjesshme të forcave serbe nga Kosova, angazhim të kufizuar të trupave të reja dhe pajisjen e tyre, si edhe pajtimin e Serbisë për praninë e paarmatosur të vëzhguesve të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian (OSBE).

Mirëpo, gjërat nuk ishin ashtu si u pajtuan palët. Veturat e spikatura ngjyrë portokalli që bartnin vëzhguesit e OSBE-së arritën në Kosovë, por kjo nuk solli ndonjë përmirësim të dukshëm të situatës. Pasuan negociatat e reja që nisën në janar 1999, por që sërish dolën të pafrytshme. Ish-Presidenti i Jugosllavisë Slobodan Milosheviq refuzoi të pranojë forca ndërkombëtare që do të garantonin ndërprerjen e veprimeve të dhunshme në provincë. Meqë ishte i bindur se shqiptarët e Kosovës dhe forcat e tyre guerile, Ushtria Çlirimtare e Kosovës (UÇK), nuk kishin ndonjë shans të arrinin ndarjen e provincës nga Serbia dhe t'i largoheshin ndikimit të Beogradit, Milosheviq refuzoi propozimet e bashkësisë ndërkombëtare, njëherë pas tjetrës. Meqë e konsideronte Kosovën si pjesë të territorit të tij, ai mendonte se çfarëdo intervenimi i huaj nënkuptonte ndërhyrje në çështjet e brendshme të një shteti të pavarur dhe nëse ndonjëherë do të merrej ndonjë vendim i tillë, ai shpresonte se Rusia, e ndoshta edhe Kina në Këshillin e Sigurimit të OKB-së do të vendosnin veton ndaj ndërhyrjes ushtarake të NATO-s. Secila nga këto llogaritje doli të jetë e gabuar.

RAMBUJE SI SHANSI I FUNDIT

Negociatat u zhvilluan në një kështjellë në qytetin e Rambujesë, diku 60 kilometra larg Parisit. Ato filluan në shkurt 1999 dhe zgjatën për

gati tri javë. Milosheviq nuk ishte i pranishëm, pasi ai qëndronte në Beograd, por e kontrollonte ekipin negociator të Serbisë. Presidenti i Serbisë atëkohë, Milan Milutinoviç, ishte i pranishëm në Rambuje dhe ndonjëherë fluturonte në mbrëmje për në Beograd për të marrë udhëzime nga Milosheviq.

Delegacioni kosovar udhëhiqej nga Hashim Thaçi, përfaqësuesi politik i UÇK-së i cili atëkohë ishte ende në të njëzetat. Ai ishte një negociator i ashpër dhe e kontrollonte ekipin negociator shqiptar, të cilët ishin më pak të unifikuar. Njëri nga anëtarët e ekipit negociator të Kosovës, për shembull, po bënte shaka me gazetarët duke u thënë se “Ibrahim Rugovën po e shoqëronin madje edhe në tualet për ta parandaluar që të hynte në ndonjë dhomë tjetër ku do ta nënshkruante marrëveshjen”.

Negociatat u shndërruan në diplomaci të ndërmjetësimit nga anëtarët e Grupit të Kontaktit, ashtu si quhej. Ky grup përbëhej nga përfaqësuesit e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Ruisë dhe të BE-së, përkatësisht Kristofer Hill, Boris Majorski dhe Wolfgang Petrish. Nuk kishte takime direkte ndërmjet delegacionit serb e atij shqiptar. Njëri nga akterët kyç të diplomacisë ishte Medlin Ollbrajt, ish-Sekretarja e Shtetit të SHBA-ve. Por as vizitat dhe diskutimet e saj të shpeshta me Thaçin nuk sollën ndonjë rezultat.

XHERRY ADAMS? JO, FALEMNDERIT

Gjatë një takimi të tillë, duke ecur në rruginat përreth kështjellës, Ollbrajt u përpoq ta bindte Thaçin që shqiptarët e Kosovës duhej ta nënshkruanin marrëveshjen për t'i zgjidhur problemet e tyre. Sipas një burimi të delegacionit shqiptar, një pjesë e bisedës shkoi kështu: “Nëse e nënshkruani atë, ne do t’ju shndërrojmë në Xherri Adamsin e ri (lideri i partisë së Sinn Féin në Irlandën Veriore, krahu politik i IRA-s)”, kishte sugjeruar Ollbrajt.

„Xherri Adams? Jo, falemnderit! IRA është në listën e organizatave terroriste, që do të thotë se

Negociatat në kështjellën e qytetit Rambuje, diku 60 kilometra larg Parisit, nisën në shkurt 1999 dhe vazhduan për gati tri javë. Slobodan Milosheviq nuk ishte i pranishëm, pasi ai qëndronte në Beograd, por e kontrollonte ekipin negociator të Serbisë. Presidenti i Serbisë atëkohë, Milan Milutinoviç, ishte i pranishëm në Rambuje dhe ndonjëherë fluturonte në mbrëmje për në Beograd për të marrë udhëzime nga Milosheviq. Delegacioni kosovar udhëhiqej nga Hashim Thaçi, përfaqësuesi politik i UÇK-së. Atëkohë, ai ishte ende në të njëzetat, një negociator i ashpër që kontrollonte ekipin negociator shqiptar, i cili nuk kishte përberje fort të mirë.



UÇK-ja do të vendosej poashtu në atë listë“, i ishte përgjigjur Hashim Thaçi asaj pa u menduar shumë. Sipas burimit të njëjtë, Ollbrajt, e cila u befasua nga kjo përgjigje, i propozoi Thaçit tri opsione: „Ju e nënshkruani, serbët refuzojnë ta nënshkruajnë, ne i bombardojmë; ju refuzoni ta nënshkruani, serbët e nënshkruajnë dhe ju do të mbeteni në mëshirën e serbëve; nëse të dyja palët refuzojnë, nuk kemi çfarë të bëjmë. Mendo për këtë“.

Lideri i ri shqiptar nuk u prek fare nga kjo. Kërkesa e tij themelore ishte e drejta për referendum për ndarje nga Beogradi, të cilën bashkësia ndërkombëtare në atë kohë nuk e përkrahte. Pa përmbushjen e kësaj kërkesë, delegacioni i tij refuzonte të negociojë. Nga ana tjetër, anëtarët evropianë të Grupit të Kontaktit avokuan për mundësinë më të mirë për autonomi të Kosovës brenda Jugosllavisë, gjë që Beogradi ishte i gatshëm ta nënshkruante, por shqiptarët e Kosovës refuzuan.

KUSHTI I RI AMERIKAN - GARANCI PËR DËSHTIM

Burimet nga Rambuje në kohën e negociatave dhe disa analiza të bëra më vonë sugjeruan epilogun e radhës së ngjarjeve. Sipas atij skenari, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, të pakënaqura me refuzimin e shqiptarëve dhe me pajtimin potencial të serbëve me pjesën politike të marrëveshjes, shtuan në çastin e fundit disa elemente të reja të cilat Beogradi padyshim se do t'i refuzonte.

Këto elemente të reja iu shtuan aspektit ushtarak të marrëveshjes. U shtua edhe një pjesë lidhur me praninë e trupave të NATO-s në Kosovë. Kërkesa e re parashihte lëvizje të papenguar nëpër Serbi. Sipas disa burimeve, kjo kërkesë zgjeroi përdorimin e lirë të barakave të ushtrisë jugosllave pa kompensim për dëmet infrastrukturore që do të rezultonin nga lëvizja e trupave. Gjatë një interviste me agjencinë Reuters, presidenti i Serbisë, Milan Milutinoviq, tha se asnjë politikan serb nuk do ta nënshkruante atë, pasi marrëveshja si e tillë nënkuptonte okupim.

Vetë marrëveshja nuk u publikua kurrë. Sidoqoftë, një pjesë e saj e publikuar vuri në pah se kjo marrëveshje parashihte krijimin e postit të „kreat të misionit për zbatimin e saj“, i cili do të autorizojë të merrte vendime që do t'i bindnin palët nënshkruese. Kreu i misionit implementues do të ishte personi i vetëm i autorizuar për të interpretuar pjesën politike të marrëveshjes, ndërsa komandanti i forcave ndërkombëtare të NATO-s do të ishte përgjegjës për interpretimin e pjesës ushtarake të marrëveshjes. Sipas informatave të zbuluara nga media, ekzistonte një dispozitë që

ishte veçanërisht e papranueshme për serbët. Ajo dispozitë thoshte se zgjidhjet e specifikuar do të zbatoheshin për tre vite dhe se pas kësaj periudhe do të merrej një vendim mbi statusin e Kosovës në një mbedhje ndërkombëtare, gjë që interpretohej si referendum për pavarësi nga ana e Beogradit. Një zgjidhje e tillë hapi mundësinë e legalizimit të ndarjes së Kosovës pas tre viteve përmes një referendumi të organizuar për popullatën shqiptare.

Nga ana tjetër, pjesa ushtarake që SHBA e përfshiu në marrëveshje si “aneksi special B” (statusi i implementimit të forcave multinacionale) thuhej se ishte formuluar në atë mënyrë që ishte e papranueshme për Jugosllavinë, meqë do të lejonte krijimin e një situatë që delegacioni serb e cilësonte si okupim ushtarak. Ndër të tjera, Aneksi B bënte thirrje për tërheqjen e të gjitha forcave ushtarake serbe e jugosllave nga Kosova me përjashtim të 1,500 ushtarëve dhe 75 policëve dhe tërheqjen e të gjithë makinerisë ushtarake nga Kosova, jo vetëm tanket, topat dhe armët e tjera të rënda, por të të gjitha mjeteve mbrojtëse.

Trupat e NATO-s do të ishin garancia për zbatimin e marrëveshjes në Kosovë. NATO gjithashtu do të ishte përgjegjëse për kontrollimin dhe rregullimin e trafikut tokësor në Kosovë dhe në zonën ajrore mbi provincë. Madje edhe zona ajrore prej 25 km jashtë Kosovës, mbi territorin e Jugosllavisë, do të ishte përgjegjësi e NATO-s. Parashihej një ndalesë për hyrjen e mjeteve ajrore jugosllave pa leje paraprake speciale nga komandanti i NATO-s. Disa akterë ndërkombëtarë që ishin të pranishëm gjatë negociatave në Rambuje pretendonin se i kishin interpretuar pjesët e marrëveshjes në mënyra të ndryshme, sidomos në aspektin politik, duke thënë se tre vite pas [hyrjes në fuqi të marrëveshjes] serbët dhe shqiptarët do të kishin të drejta të njëjta për vendimmarrje. Sipas disa burimeve, Perëndimi nuk u pajtua në të vërtetë që Kosova të lejohej të merrte më shumë se sa një autonomi të zgjeruar.

NATO E BASHKUAR (NDARË)

Gjatë negociatave u shfaqën disa krisje brenda vetë Aleancës. Italianët vazhdimisht insistonin për një marrëveshje që të shmangej bombardimi i Jugosllavisë. Edhe disa anëtarë të tjerë ishin në mëdyshje sa i përkiste përfundimit të konfliktit në Kosovë përmes ndihmës ndërkombëtare, por në fund triumfoi nevoja për të ruajtur unitetin brenda NATO-s, meqë Aleanca po mbushte gjysmëshekullin e parë që nga themelimi i saj me 4 prill 1949.

Pas 18 ditëve të negociatave të zhvilluara në shkurt në Rambuje, ato vazhduan në mars

në Paris, ku të dyja delegacionet do të jepnin përgjigjen e tyre përfundimtare rreth nënshkrimit apo refuzimit të marrëveshjes. Pala shqiptare informoi diplomatët se do ta nënshkruante marrëveshjen; delegacioni serb paraqiti një varg amandamentesh lidhur me pjesën politike, ndërsa refuzoi në tërësi pjesën ushtarake të marrëveshjes.

Serbët kërkonin më shumë kohë dhe ndonjëse presidenti amerikan, Bill Clinton, u tha gazetarëve se mbase mund të ishte e rëndësishme të pritej për pak kohë, kjo nuk ndodhi. Të tjerët mendonin se nuk kishte kuptim të bëheshin përpjekje për t'i akomoduar „taktikat e obstruksionit serb“, siç i quanin, në një kohë kur, sipas të dhënave nga shërbimet e inteligjencës, Jugosllavia po rriste praninë ushtarake në provincë.

Pas 'PO'-së së shqiptarëve dhe 'JO'-së së serbëve, më 24 mars 1999 nisi bombardimi i Jugosllavisë i cili zgjati 78 ditë. Ai përfundoi me nënshkrimin e Marrëveshjes së Kumanovës, të cilën Milosheviq e pranoi pasi ishte këshilluar për ta bërë këtë nga politikani rus, Jevgenij Primakov. Sipas një burimi të afërt me presidentin jugosllav, Primakov i kishte thënë atij se Rusia nuk do të mund ta ndihmonte për të ndaluar bombardimet dhe se nuk mund të garantonte se, po qe se do të vijonte ndonjë ndërhyrje tokësore e paplanifikuar, NATO do të ndalonte në kufirin administrativ të Kosovës.

FRANCEZËT DHE GAZETARËT

Gazetarët raportonin për ngjarjet në Rambuje nga kafeteritë atypari dhe duke ecur rrugëve në afërsi të kështjellës, ku hyrja ishte e ndaluar. Francezët fillimisht mendonin të krijonin një qendër për media, por hoqën dorë nga kjo ide, për shkak, siç thonë burimet, të shpresës se numri i gazetarëve do të zvogëlohej si pasojë e përkeqësimit të kushteve të tyre të punës.

Julijana Mojsilović është gazetare nga Beogradi. Ajo ka punuar për një shumë media në rajon (Slobodna Dalmacija, Jutarnji list, Balkan Insight), si dhe për media dhe agjenci ndërkombëtare të lajmeve (Associated Press, Reuters). Ajo ka punuar si eksperte e marrëdhënieve publike për kompani ndërkombëtare dhe si këshilltare për marrëdhënie publike në kabinetin e Zoran Gjingjiqit. Ajo kryesisht merret me krizat e marrëdhënieve ndërkombëtare. Julijana Mojsilović jeton dhe punon në Beograd.

Marrëveshja për Paqë kryetitujt e portaleve në shtypin e Bosnje

Kryetitujt promovojnë artikujt, ndaj janë me rëndësi kyçe se sa do të lexohen shkrimet. Në mënyrë që një kryetitull të jetë interesant dhe të tërheqë vëmendjen e lexuesve, përdoren citatet kryesore nga shkrimi dhe që përçojnë një mesazh të rëndësishëm. Sa i përket raportimit mbi Marrëveshjen për Paqë të Dejtonit, shoqëria në Bosnje e Hercegovinë ende po pret mesazhe të rëndësishme që do të shënonin ndryshime konkrete.

Marrëveshja për Paqë e Dejtonit konfirmoi ndarjet etnike dhe pasojat e luftës. Ajo detyroi qytetarët të ndahen në grupe etnike dhe hapi dyert për klientelizëm dhe korrupsion në të gjitha sferat. Bazuar në kryetitujt e mediave të Bosnje e Hercegovinës, mund të ndjehet agonja që ka sjellë Marrëveshja për Paqë e Dejtonit. Ato vënë në pah mospajtimet dhe pamundësinë për të bërë kompromis, bllokadat për ndryshim dhe “luftën e ngrirë”, siç thotë një nga kryetitujt.

Mediat i kushtuan vëmendje të madhe pasojave të Marrëveshjes për Paqë të Dejtonit në përvjetorin e saj të njëzetë dhe këtë e bënë me vend. Gazetari e analisti politik amerikan, Franco Galdini, e quan Bosnje e Hercegovinën një “shtet me tre presidentë, 13 kryeministra dhe pa ndonjë qeveri të duhur” duke nënvizuar faktin se ndërmjetësimi amerikan në krijimin e Marrëveshjes për Paqë të Dejtonit e ka kthyer Bosnje e Hercegovinën në kaos për njëzet vjet pas luftës.

Pavarësisht kësaj, në politikën ndërkombëtare, Marrëveshja për Paqë e Dejtonit po përdoret gjithnjë e më shumë si një projekt i suksesshëm që do të duhej të shërbente si model për zgjidhjen e konfliktit në Siri.

Radio Sarajevo: kryetitujt e gazetës

Paqe e Dejtonit në e të lajmeve dhe e Hercegovinës

- 1_ Kongresi kërkon një emisar special për Bosnje e Hercegovinën.

Shtetet e Bashkuara të Amerikës kërkojnë verifikimin e efekteve të Marrëveshjes së Dejtonit. Rezoluta e Kongresit Amerikan ka për qëllim përshpejtimin e anëtarësimit të Bosnje e Hercegovinës në BE; reformat kushtetuese bazuar në Marrëveshjen e Dejtonit duhet të implementohen; ka vështirësi në themelimin e institucioneve politike efçiente, siç edhe thuhet në rezolutë.

- 2_ Sot është përvjetori i Dejtonit: marrëveshja që ngriu luftën

- 3_ Mesiq: Dejtoni ka krijuar një shtet jofunksional

Marrëveshja e Dejtonit - marrëveshja e përgjithshme kornizë për paqe në Bosnje e Hercegovinë me 12 anekse u nënshkrua në këtë datë para 18 vjetësh

- 4_ 20 vite më vonë: Dejtoni bëhet prapë arsye për mospajtim në mes të Dodikut dhe Izetbegoviqit

- 5_ Përvjetori i shtatëmbëdhjetë i Dejtonit

Marrëveshja për Paqe e Dejtonit, e cila u nënshkrua me 21 nëntor 1995 nga Presidenti i atëhershëm i Bosnje e Hercegovinës Alija Izetbegoviq, Presidenti i Kroacisë Franjo Tugjman dhe Presidenti i Serbisë Slobodan Milosheviq, i dha fund zyrtarisht luftës tre-vjeçare në Bosnje e Hercegovinë.

- 6_ Banja Luka: Konferenca me rastin e përvjetorit të njëzetë të Dejtonit u hap me punimin “Na jepni paqe”. Mesiq në favor të Dejtonit 2 dhe të një Bosnje e Hercegovine të përbërë nga kantone shumë-etnike

- 7_ Mesiq shprehet pro Dejtonit 2 dhe idesë që Bosnja e Hercegovina të përbëhet prej kantoneve multi-etnike.

Ish-Presidenti i Republikës së Kroacisë

Stjepan Mesiq, beson se ka ardhur koha për një konferencë të re ndërkombëtare ku do të disuktohej ndryshimi i përbërjes së brendshme të Bosnje e Hercegovinës, ndërsa propozimi i tij është riformimi i Bosnje e Hercegovinës në një shtet qytetar të përbërë nga disa kantone multi-etnike.

- 8_ Shpалosja e “Dejtonit” është e rrezikshme për Srpskan

Deklarata e Parlamentit Nacional të Kroacisë për krijimin e katër njësive federale nënkupton shpалosjen e Marrëveshjes së Dejtonit, gjë që është shumë e rrezikshme për Republika Srpskan, thanë deputetët e Partisë Demokratike Serbe (SDS) dhe ata të Lëvizjes Kombëtare Demokratike (NPD) në Këshillin Përfaqësues të Asamblesë Parlamentare të Bosnje e Hercegovinës gjatë një interviste në programin televiziv “Sfidat” në TV BN. Mbështetja nga Zëvendëspresidenti i Aleancës së Socialdemokratëve të Pavarur (SNSD) për Deklaratën e Partisë së Popullit Kroat (HNS) është tradhti kombëtare, tha deputetja e SDS-së Aleksandra Pandureviq.

- 9_ Kundër rivizatimit të kufijve në Ballkan

Me rastin e përvjetorit të Marrëveshjes për Paqe të Dejtonit, Profesori David Çandler tha se beson që marrëveshja është e mirë jo vetëm për bashkësinë ndërkombëtare.

- 10_ Radmanoviq: Nëse e kemi Dejtonin, nuk na duhet referendumi

Radmanoviq dhe Nikoliq diskutuan për situatën aktuale politike në rajon dhe për Luftën e Parë Botërore

- 11_ Picula: Marrëveshja e Dejtonit duhet të amendamentohet - Bosnje e Hercegovinës i duhet një kushtetutë e re

Zagreb: “Sistemi në Bosnje e Hercegovinë duhet të ndryshohet në tërësi. Dejtoni po bëhet një pengesë serioze për çfarëdolloj nisme rreth vendosjes së një demokracie evropiane në Bosnje e Hercegovinë, me një ekonomi prosperuese” tha Toni Picula, anëtar i Parlamentit Evropian.

- 12_ Dejtoni duhet të zbatohet, jo të amendamentohet

- 13_ “Vetëm Dejtoni mund ta ndihmojë Srpskan në Bosnje e Hercegovinë”

Rishikimi i Marrëveshjes për Paqe të Dejtonit që kërkohet nga shtetet perëndimore ka për qëllim zhdukjen e Republika Srpskas dhe për këtë

arsye, të gjitha partitë politike serbe në Bosnje e Hercegovinë duhet ta kenë një qëndrim të përbashkët”. Ky ishte mesazhi i Asamblesë së Asociacionit ‘Krijuesit e Republika Srpskas’ që u mbajt në Pale.

14_ A ka ardhur koha të amendamentohet Marrëveshja e Dejtonit?

Disa në Bosnje e Hercegovinë e shohin si “këmishë të forcës” të vënë mbi Bosnje e Hercegovinë, ndërsa të tjerët e cilësojnë si një “garanci për mbrojtjen e interesave kombëtare”. Të gjendet ndërmjet këtyre dy opsioneve, ky vend ka mbetur në vendnumëro për 19 vjet që nga nënshkrimi i Marrëveshjes së Dejtonit

15_ Dejtoni: Asgjë e re edhe pas 14 vjetësh

Marrëveshja për Paqe e Dejtonit është nënshkruar këtë datë në vitin 1995 në bazën ushtarake amerikane Wright Patterson Dayton

16_ Sot është përvjetori i Dejtonit, marrëveshjes që ndali luftën

“Kjo nuk është vetëm paqe, por është më shumë se sa vetëm një vazhdim i luftës. Në një situatë të tillë, në një botë të tillë, nuk do të mund të arrihej një paqe më e mirë”, tha Presidenti i parë i Presidencës së Republikës së Bosnje e Hercegovinës Alija Izetbegović, duke folur në Versajë të Parisit duke u dridhur pas ceremonisë së nënshkrimit të Marrëveshjes për Paqe të Dejtonit me 14 dhjetor 1995.

17_ Përvjetori i shtatëmbëdhjetë i Dejtonit

Marrëveshja që ngriu luftën

18_ Tri javë pas negociatave në Ohajo

Një paqe hutuese

19_ Një fund dramatik i negociatave për Bosnjen në Dejton

Lëvizjet diplomatike në Dejton



Adis Susnjarić ka punuar në Sarajevë në bordin redaktues të gazetës “Nezavisne novine” në vitet 2005 dhe 2010. Ai ka qenë zyrtar koordinues si pjesë e ekipit rajonal për marrëdhënie publike për promovimin e nismës për themelimin e Komisionit Rajonal për gjetjen e fakteve për krimet e luftës dhe shkeljeve më të rënda të të drejtave të njeriut në territorin e ish-Jugosllavisë (REKOM). Aktualisht, ai punon si koordinator në Asociacionin e Gazetarëve të Bosnje e Hercegovinës. Ai ka kryer studimet në programin një-vjeçar për gazetari “Plani i mediave” në Institutin e Sarajevës (Departamenti për Media) dhe studimet në Fakultetin e Filozofisë në Sarajevë (Departamenti për Letërsi Krahasuese dhe Studime Bibliotekare) në 2004.



4



● Cfarë është Dejtoni për ne?

Nuk jam mjaft e sigurtë se deri në ç'masë është e këshillueshme që njëzet vjet më pas, ta rikujtoj kohën kur tymi i paqes u shfaq në bazën ushtarake Wright-Patterson. E di se një muaj para se të ndodhte, kjo kisha dëgjuar për qytetin e Dejtonit ku pritej të mbaheshin negociatat. Pavarësisht se çka thuhet për të tani, më duhet të them se ende ushqej ndjenjën e shpresës. Në kohën kur është nënshkruar Marrëveshja për Paqe, biri im shkante në klasë të parë të shkollës fillore. Ndoshta mund të jetë tërësisht egoiste, por pesë-gjashhtë minutat që i duheshin për të arritur në shkollë ishin një ankth i vërtet për mua. Bashkëshorti im u vra në qershor, vetëm dhjetë ditë pasi ne të dy, në mes të luftës në Sarajevë, dërguam djalin tonë për në shkollë. Psikologët mbase do të shoshin se unë, për shkak se doja të shtypja humbjen, kisha projektuar pikëllimin dhe frikën time tek djali ynë. Sidoqoftë, isha e sigurtë se lufta nuk kishte si të më hynte më shumë nën lëkurë.

Në periudhën në mes kohës së atëhershme dhe të tashmës, e kam vështirë të numëroj rastet kur kam përshkruar Marrëveshjen e Dejtonit (një sinonim për paqe dhe përkufizim për problemet e shumta të pasluftës) si kanë bërë të gjithë të tjerët: si një këmishë të forcës, një pengesë për progres, si keqbërësin më të madh dhe shkaktarin e pamundësisë për t'u bërë shtet normal. Megjithatë, asnjëherë nuk e kisha kuptuar gjënë më të rëndësishme që ajo solli me vete: fundin e luftës.

Jam takuar me Riçard Hollbrukun. Kjo ka ndodhur vetëm disa vite pas nënshkrimit të marrëveshjes dhe më kujtohet se ai nuk ishte plotësisht i kënaqur me zgjidhjet e dizajnuara me Marrëveshjen e Dejtonit. Por energjia e tij e padyshimtë për të sjellë bashkë të papajtuësmit dhe për t'i pajtuar palët ndërluftuese spikatej në secilin gjest të tij, që shoqëronte të gjitha shpjegimet: Po! Marrëveshja e Dejtonit nuk është ideale, por ajo solli paqen dhe tani u takon qytetarëve të Bosnje e Hercegovinës: serbëve, boshnjakëve, kroatëve, që të pajtohen, ta amendamentojnë dhe ta përmirësojnë.

Gjatë jetës së tij, Hollbruk avokoi për një zbatim më të fuqishëm të Marrëveshjes për Paqe të Dejtonit. Sidoqoftë, ai nuk shqetësohej kur duhej thënë se anëtarët e Këshillit të Paqes për Zbatim nuk arritën të ofrojnë mbështetjen e duhur. Fakti që ai ishte vizionar mbështetjet nga ajo që me rastin e pesë vjetorit të Dejtonit, ai publikisht avokoi për një anëtarësim më agresiv të Bosnje e Hercegovinës në BE. Ai madje kritikoi ish-komandantin e forcave të NATO-s, gjeneralin amerikan Smith, për veprimet e pamjaftueshmë drejt anëtarësimit të Bosnje e Hercegovinës në aleancë.

Me një saktësi tipike amerikane, ai ishte gjithashtu në gjendje t'i përcaktojë akterët vendorë: ai nderoi Alija Izetbegovićin për kurajon e tij për të qëndruar në Sarajevë dhe gjithnjë theksonte se pikërisht për këtë arsye Slobodan Milosheviq ngriti flamurin e bardhë të kapitulumit për të hequr dorë tërësisht nga Sarajeva. Por ai nuk e fshihte pakënaqësinë e tij me angazhimin e pamjaftueshëm të partisë së Izetbegovićit, SDA-së, në krijimin e shtetit multi-etnik. Që atëherë, 15 vjet më parë, ai nuk kishte asnjë dyshim: statusi i Kosovës, temë tejet e nxehtë rajonale në atë kohë, nuk do t'i ndryshonte kufijtë e

Bosnje e Hercegovinës; Republika Srpska do të mbetet një entitet, sikurse që do të mbehte Federata. Kur fliste për të ardhmën e Bosnje e Hercegovinës, ai preferonte fuqizimin e vetë-qeverisjes lokale, një nga modelet që Evropa i sheh si arritje të sajën.

Asnjë nga akterët kyçë të Marrëveshjes së Dejtonit (Izetbegović, Milosheviq, Hollbruk dhe Franjo Tuđman) nuk janë më gjallë. Por Dejtoni është. Ngdojëherë, në këtë shportë të politikës vendore, kjo marrëveshje duket më e gjallë se kurrë.

Në fakt, kjo përmban një të vërtetë të madhe, mbase më të madhen. Dejtoni është një kornizë ku, siç e kemi parë, bazuar në përvojën tonë gjatë njëzet viteve të kaluara, ne mund të lëvizim, të takohemi dhe të punojmë. Në kuadër të saj, ne mund ta marrim fatin në duart tona dhe të jemi të kemi përgjegjësi për të. Përdorimet e shpërdorimet e Dejtonit janë një çështje krejtësisht tjetër. Padyshim, Dejtoni është fajtori më i vogël për politikën e dobëta, për pasurimin e paskrupullt të elitave në kurriz të popullit, për gjendjen skandaloze ekonomike, për pagat e ulëta dhe pensionet e mjerueshme.

Fajtorët për këtë moçal të korrupsionit dhe të krimit ku jetojmë janë politikanët. Ata e shohin veten si pronarë të këtij shteti, feje dhe populli. A e ndalon Dejtoni ndonjë zyrë prokuroriale apo gjykatë, duke filluar nga gjykata e prokuroria komunale e deri të Gjykata e Prokuroria e Bosnje e Hercegovinës, të luftojnë krimin e organizuar, politikanët lakmitarë apo çfarëdo lloj tjetër të mafias? A i pengon Dejtoni ambiciet e ndonjë qeverie për të investuar paratë e taksapaguesve në fabrikat apo krijimin e vendeve të reja të punës në vend se të futen ato para në xhepat personale? Ky është thelbi i tregimit tonë. Dejtoni është lecka e kuqe që ata e përdorin për të na frikësuar, për ta rritur frikën [e popullit] dhe për t'i fuqizuar armiqësitë duke i gjetur vetes alibi të ndryshme. Këtë e bëjnë për të shmangur paraqitjen e justifikimeve për krimet e kryera kundër popullit të tyre apo, për më keq, për t'u detyruar t'i kthejnë ato para.

Vildana Selimbegović ka lindur në Travnik më 1963, ku ndoqi mësimet në shkollën e mesme lokale. Ajo më vonë mbaroi studimet në Departamentin e Gazetarisë të Fakultetit të Shkencave Politike në Sarajevë. Nga viti 1988 deri në vitin 1994, ajo punoi në 'Večernje novine' në Sarajevë. Më 1994 ajo doli në revistën 'Dani,' ku kreu detyrën e redaktores, asistentes së kryeredaktorit, zëvendëskryeredaktores, drejtoreshës ekzekutive, zëvendës-shefes dhe në dy raste punoi si kryeredaktore (2000-2003 dhe 2005-2008). Për shkak të punës së saj profesionale dhe angazhimit të saj, ajo fitoi çmimin Žene 21 (1997-2001) dhe më 1998 ajo fitoi një çmim nga BE-ja dhe Qeveria Amerikane për kontributin e saj në zhvillimin e demokracisë dhe respektimin e të drejtave të njeriut. Që nga tetori i vitit 2008 ajo kryen detyrën e kryeredaktores së gazetës Oslobodjenje.

••••

Mefail Ismaili

NDALOI KONFLIKTIN, POR JO INCIDENTET NDËRETNIKE

-

MARRËVESHJA E OHRIT DËSHTOI, PASI U PËRDOR PËR INTERESA POLITIKE

Marrëveshja e Ohrit është një dështim politik. Ajo është përdorur për interesa politike nga partitë në pushtet, që edhe 15 vite pas nënshkrimit, ende flasin për implementimin e saj. Nëse do të ishte implemtuar si duhet, tani Maqedonia nuk do të ballafaqohet me këtë krizë politike që nuk mund të zgjidhet as me presionin e faktorit ndërkombëtar.

••••

Marrëveshja e Ohrit ka dështuar. Nëse ajo do të ishte implementuar në përputhje me dinamikat e parashikuara, Maqedonia do të ishte në NATO dhe më pranë Bashkimit Evropian. Vendi nuk do të ballafaqohej me kriza politike dhe ekonomike, por as me migrimin e qytetarëve që nuk e shohin të ardhmen në vendlindjen e tyre. Kështu e përshkruajnë qytetarët e Maqedonisë implementimin e Marrëveshjes së Ohrit.

Profesori i Halit Lita është një nga të shumtët që besojnë se dështimi i implementimit të Marrëveshjes së Ohrit do t'i kushtojë rëndë ardhmërisë së Maqedonisë. “Marrëveshja e Ohrit është një dështim politik që do t'i kushtojë shumë rëndë Maqedonisë, shumë më shumë se konflikti dhe periudha e mosimplementimit së bashku. Fajtorë kryesorë janë partitë në pushtet: VMRO DPMNE dhe BDI, që e kanë shfrytëzuar procesin e implementimit për të fituar zgjedhjet”, shpjegon Halit Lita. Ai shton se “Maqedonia ka nevojë për një marrëveshje aneks afatshkurtër për implementim të menjëhershëm të Marrëveshjes së Ohrit, apo për një Marrëveshje të re, e cila do të përfshijë [zgjidhje] për krizën politike dhe ekonomike, gjyqësorin dhe krizën e para 2001-it”.

Hamza Saliu nga Shkupi, tani në pension, beson se nëse Marrëveshja e Ohrit do të ishte implementuar në kohë, Maqedonia tashmë do të kishte qenë anëtare e NATO-s dhe më pranë Bashkimit Evropian. “Pse? Sepse nuk do të kishte nevojë [që qeveria] të merrej me përfaqësimin e drejtë të bashkësive etnike, sidomos asaj shqiptare, në institucionet e Maqedonisë dhe askush nuk do të fliste për përdorimin e flamurit shqiptar apo për raste të montuara kundër shqiptarëve”, thekson Saliu. Ai shton “Nëse Marrëveshja e Ohrit, e cila ishte arsyeja kryesore pse u ndalua konflikti i vitit 2001 do të ishte implementuar në tërësi, atëherë vendi ynë nuk do të ballafaqohej me sfida të tilla si kriza politike, që nuk mund të zgjidhen as nga faktori ndërkombëtar; nuk do të kishte patur krizë ekonomike dhe as incidente ndëretnike në vend si sulmet nëpër autobusë

kundër shqiptarëve, si dhuna e shkaktuar nga huliganët në Shkup, apo arrestime për raste të montuara”.

Ndërsa Krenar Bekri, i cili punon në një mobileri private thotë “Fakti që edhe 15 vite pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Ohrit mbahen tryeza për të diskutuar nevojën e implementimit të saj vë në dukje se ka vonesa shumë të mëdha në implementim”.

“Edhe pse nuk është implementuar, Marrëveshjes së Ohrit i ka rënë pesha”, ka shtuar ai. Sipas tij, partitë politike në pushtet e kanë përdorur marrëveshjen për të fituar pike politike, sidomos gjatë kohës së zgjedhjeve “Pse e them këtë? Këtë e them, sepse kjo marrëveshje jo vetëm është shfrytëzuar për të punësuar njerëz, por më e keqja është se në bazë të kësaj marrëveshjeje të rinjtë shqiptarë janë punësuar, por me vite të tëra nuk kanë vende pune të përhershme. E vetmja gjë që bëjnë është të rrinë në shtëpi dhe të marrin rrogat. Edhe pse kjo mund të duket mirë, mendoj se është diçka e dëmshme, sepse kuadrot shqiptarë po humbin kohë të vlefshme duke ndejtur në shtëpi, kohë gjatë së cilës mund të fitojnë përvojë pune në profesionin e tyre, por edhe të avancojnë në institucionet ku duhet të punojnë. Kjo e konfuzon një pjesë të rinisë, të cilët pastaj kërkojnë mënyra ta lënë vendin dhe të migrojnë”, shton Bekri.

Njerëzit besojnë se si pasojë e papërgjegjësisë së partive politike VMRO-DPMNE-së që përfaqëson maqedonasit dhe BDI-së (Bashkimi Demokratik për Integritet) që përfaqëson shqiptarët, Marrëveshja e Ohrit është keqpërdorur edhe në baza etnike. Kështu, ekziston perceptimi se Ligji për Përdorimin e Gjuhës Shqipe, për Përdorimin e Flamurit Shqiptar dhe për Përfaqësimin Adekuat të Shqiptarëve në Institucione është keqpërdorur.

Vlado Popovski: Mungon promovimi pozitiv për Marrëveshjen Kornizë të Ohrit në mënyrë që të tejkalohet mosbesimi

Në vitin 2001, Vlado Popovski, profesor në Fakultetin Juridik, ishte këshilltar gjatë krijimit të Marrëveshjes Kornizë të Ohrit. Ai thotë se që nga atëherë, në Maqedoni është shënuar shumë progres në fushën e barazisë, por se puna për këtë ende nuk ka përfunduar. Sipas Popovskit, pengesa më e madhe në rrugën e integritetit janë disa parti politike brenda vendit. Në përpjekje për t'i fituar zgjedhjet, këto parti shpesh dëmtojnë marrëdhëniet ndër-etnike. Në këtë kontekst, profesori thotë se shpesh mungon promovimi pozitiv i benefiteve të Marrëveshjes Kornizë të Ohrit (MKO).

Cila është ajo frymë e Marrëveshjes Kornizë të Ohrit që mungon në implementimin e saj?

Sipas MKO-së, Republika e Maqedonisë duhet të mbetet e unifikuar dhe integriteti i saj territorial nuk duhet të priset. Republika e Maqedonisë është një shoqëri multi-etnike dhe duhet të mbetet e tillë. Kjo gjë duhet të pasqyrohet në të gjitha sferat e jetës publike. Njerëzit duhet ta kenë të drejtën për identitet, për përdorimin e lirë të gjuhës, kulturës, arsimit, të përdorimit të simboleve dhe të alfabetit të tyre. Barazia duhet të jetë e pranishme për të gjitha grupet që jetojnë në Maqedoni. Kjo frymë është dizajnuar dhe konceptuar si instrument i qëndrueshmërisë dhe zhvillimit të demokracisë. Së pari duhet që demokracia të kuptohet si koncept i mosdiskriminimit, si koncept i gjithëpërfshirjes së të gjithëve në mënyrë të barabartë.

Ali Ahmeti thotë: „Fati i Maqedonisë do të varet nga marrëdhëniet ndërmjet maqedonasve dhe shqiptarëve“. A ka ndihmuar MKO-ja në ndërtimin e marrëdhënieve më të mira?

Mendoj se po, ka ndihmuar. Unë jetoj në Radishan, që është një zonë shumë e ndjeshme. Aty dominon popullata maqedonase, por ka edhe familje shqiptare me të cilat jemi miq dhe i ndihmojmë njëri-tjetrit. Fushat kryesore ku bashkësitë kanë respekt të ndërsjellë janë ato fusha me rëndësi kyçe si: siguria shoqërore, punësimi, arsimit, përdorimi i gjuhës dhe kulturës. Në këtë drejtim, MKO-ja sjell një sistem të tërë zgjidhjesh, që janë rezultat i analizimit të situatave të mëparshme, që nuk ishin aspak të këndshme.

Si ishin kushtet para nënshkrimit të MKO-së?

Për pesë dhjetëvjeçarë me radhë nën sistemin e mëparshëm, kishte një theks deklarativ mbi barazinë ndërmjet maqedonasve, shqiptarëve dhe bashkësive të tjera; se ata janë të barabartë, se kanë të drejta të barabarta për arsim dhe punë. Mirëpo situata aktuale ka treguar se gjatë 50-60 viteve të fundit ka pasur diskriminim të lartë dhe të dukshëm kundër bashkësive pakicë, sidomos kundër shqiptarëve. Në vitin 2001, nga të gjithë fëmijët shqiptarë që përfunduan shkollën fillore, vetëm 5 deri në 6.5 përqind vazhduan edukimin në shkolla të mesme. Pra, 94 përqind e tyre mbetën në nivel të shkollimit fillor.

Si ishte gjendja për fëmijët maqedonas?

Nëntëdhjetë e katër përqind ndiqnin shkollimin e mesëm. Kjo prani tregon se mundësitë për arsim dhe avancim ishin katër herë më të vogla për shqiptarët. Për shkak të arsimit të tyre, kjo popullsi vazhdimisht parashihej të zinte pozitën më të vështira dhe më të ulëta në tregun e punës. Ata nuk mund të bëheshin inxhinierë, nuk kishte mjaft mësues, profesione këto që kërkonin shkollim të lartë. 1.5 deri në 2.5 përqind ishin pjesë e arsimit të lartë, që do të thotë se kishte një diskriminim të vërtetë edhe në arsimin e lartë. Sot, gati 90 përqind e fëmijëve shqiptarë ndjekin shkollimin e mesëm. Deri në vitin e kaluar, 29 përqind nga 100 nxënës ishin shqiptarë dhe 24.7 përqind e popullatës. Tani mund të themi se nuk ka më pengesa.

Si ka ndihmuar MKO-ja në tejkalimin e këtyre kushteve?

Vetë bashkësia i ka theksuar këto probleme në mënyrë drastike. Në vitin 2001 ka pasur një konflikt, që kishte shkaqe të tjera, por fokusi kryesor kishte të bënte me çështjen e barazisë, të drejtat dhe liritë e komunitetit shqiptar. Po të mos kishte zgjidhje territoriale për çështjet etnike, ato duhej të zgjidheshin brenda sistemit. MKO-ja njohu të gjitha të drejtat dhe krijoi mekanizma për miratimin e disa ligjeve të caktuara. Këta mekanizma përfshijnë një kompleks të interesave të identitetit, përdorimit të gjuhës, qasjes në arsim, qeverisjes lokale, përdorimit të simboleve, kulturës. U krijua parimi i „ shumicës së Badinterit“. Çdo ligj duhet të marrë një shumicë votash nga përfaqësuesit që u takojnë bashkësive minoritare. Përfaqësimi i drejtë iu bashkua korpusit të vlerave kushtetuese. Pasi bëhet pjesë e kushtetutës, asnjë ligj nuk mund të miratohet pa siguruar masat për përfaqësim të drejtë. Në 14 vjet, kushtet që mbizotëruan për 50-60 vite ndryshuan radikalisht.

Gjatë viteve të kaluara, Qeveria nuk ka zbatuar masa për ndërtimin e besimit ndërmjet bashkësive, bashkëjetesës dhe pranimit të ndërsjellë. A mund ta sigurojë MKO-ja këtë?

Ajo që sigurohet nga MKO-ja është e shkruar dhe ajo që nuk sigurohet me të nuk përbën ndonjë pengesë. Ka mungesë masash për të rritur besimin e ndërsjellë në frymën e integritetit dhe solidaritetit ndërmjet qytetarëve, masash për të rritur besimin e qytetarëve tek shteti, për ta ndjerë shtetin si të tyrin, avokimit për përmirësimin e jetës së bashkësisë. Ky është kuptimi i promovimit pozitiv të MKO-së dhe zgjidhjeve të saj. Në këtë drejtim, ka disa mangësi. Promovimi i MKO-së nga politikanët maqedonas është i pamjaftueshëm. Mendoj se deri diku MKO-ja përkufizohet negativisht në disa qarqe ideologjike e politike të Maqedonisë. Perceptimi i tyre është se marrëveshja ka marrë diçka nga maqedonët dhe ua ka dhënë shqiptarëve.

Pse është ende kështu?

Mund të konkludoj se ekziston një dozë e konservatizmit tek maqedonasit lidhur me shqiptarët, një shkallë e paragjykitimit. Shqiptarët shihen si bashkësi që nuk e marrin parasysh

unifikimin me Maqedonisë, por me Shqipërinë. Mirëpo unë mendoj se këto pretendime janë manipuluese dhe të instrumentalizuara, duke supozuar se qytetarët mbështesin politikën konservative maqedonase që çojnë drejt mbështetjes së zgjedhjeve. Sikurse në korpusin politik maqedonas, ashtu dhe në atë shqiptar, ekziston një mprehje e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe kërcënimit të këtyre marrëdhënieve tashmë i ka kaluar koha. Qytetarët kanë vërtetuar se janë kundër politikave që vazhdimisht i konsiderojnë marrëdhëniet ndër-etnike si armiqësore. Manipulimi i marrëdhënieve ndër-etnike me qëllimin për të ruajtur renditjen dhe për të fituar pikë është ende një faktor negativ që pengon përmirësimin e marrëdhënieve. Ka ende mosbesim. Ka ende mjaft promovim negativ të MKO-së, edhe pse qeveria aktuale plotësisht i kryen detyrimet e veta, sjell çdo vit nga një plan veprimi dhe pajtohet për çështjen e punësimeve. Ata ndërmarrin hapa, por nuk promovojnë në mënyrë pozitive atë që bëjnë. Në vend të kësaj, ata e prezantojnë marrëveshjen si me detyrim „Shikoni, ne nuk do ta bënim këtë, por duhet“.

Çfarë mendoni për ngjarjet në Goshnicë, Kumanovë apo tragjedinë në Liqenin e Smilovskos?

Spekulohet shumë se ishte konflikt shqiptaro-maqedonas. Rastet nuk janë mbyllur ende. Qytetarët, pavarësisht përkatësisë së tyre etnike, e kanë gjykuar vetë atë që ka ndodhur në Kumanovë. Nuk besoj asgjë, por personalisht kam dyshimet e mia. Ka patur spekulime se ka qenë rast i kurditur dhe se motivi ka qenë tjetër nga ai që është përmendur. Të gjitha problemet tona vijnë nga lartë, jo nga poshtë. Por kemi një ndryshim drastik, një hap përpara, kemi rezultate. Kjo është gjendja.

A është çështja e federalizimit në kundërshtim me MKO-në?

Kjo është një ide manipuluese e qendrave të papërgjegjshme, pavarësisht a janë maqedonase apo jo. MKO-ja thekson se karakteri unikues dhe integriteti territorial duhet të mbesin. Çdo gjë jashtë këtij përkufizimi jo vetëm është në kundërshtim me MKO-në, por është edhe në kundërshtim me kushtetutën. Natyra multi-etnike e Republikës së Maqedonisë duhet të mbetet në secilën sferë. Çfarëdo diskutimi i federalizimit nuk është vetëm i pafavorshëm, por edhe i dëmshëm, për shkak se sipas të gjitha gjasave, vendos kufij të brendshëm administrativë dhe politikë. Qëndrueshmëria e shtetit është e mundshme vetëm përmes barazisë së plotë të qytetarëve.

Marrëveshjet e Brukselit

progres apo proces?

“Marrëveshjet e Brukselit” që u arritën në prill 2013 ndërmjet Serbisë dhe Kosovës, si dhe dialogu i vazhdueshëm, janë cilësuar si çast historik në raportet ndërmjet Prishtinës e Beogradit, një pajtim se të dyja palët do të punojnë së bashku për të reduktuar tensionet dhe për të negociuar qëndrimet e ndryshme kyçe, duke mos bllokuar njëra-tjetrën në rrugën drejt Bashkimit Evropian. A është e vërtetë kjo? Apo është dialogu i ri vetëm një formë e re për mosmarrëveshje të vjetra?



Prill 2013 - Pas dhjetë raundesh të negociatave pa fund, diku thellë në burokracinë e BE-së në Bruksel dhe nën syrin vigjilent të Baroneshës Kethrin Eshton, Kryeministri i Kosovës Hashim Thaçi dhe Kryeministri i Serbisë Ivica Daçiç nënshkruan një listë të parimeve dhe obligimeve mbi të cilat kishin rënë dakord, me qëllim të normalizimit të raporteve ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit. Nënshkrimet i detyruan ata të dy që të zgjidhin një sërë mosmarrëveshjesh të ngrira, përfshirë rregullimin e kornizave ligjore për të lejuar që institucionet e sundimit të ligjit në Kosovë të operojnë në tërë territorin e saj dhe zhbërjen e strukturave paralele serbe të financuara nga Beogradi. Ndërkohë, serbëve të Kosovës do t'u garantohej vend në strukturat e Kosovës dhe do të krijohesh një Asociacion i Komunave Serbe në përputhje me Kartën Evropiane për Vetë-Qeverisje Lokale, në përputhje me ligjet e Kosovës. Më në fund, të dyja palët do ta linin anash çështjen e pavarësisë së Kosovës duke garantuar se asnjëra palë nuk do ta bllokojë palën tjetër në anëtarësimin në organizata rajonale e ndërkombëtare, duke ia hapur rrugën negociimit të disa marrëveshjeve të tjera teknike. Pas disa muajsh negociatash, Marrëveshja e Brukselit, siç quhet, u bë fakt. Por çfarë nënkuptonte kjo? A kishte nisur një epokë e re e marrëdhënieve Kosovë-Serbi? A ishin të dyja palët e gatshme

ta diskutonin për të ardhmen duke lënë anash qëndrimet e ndryshme dhe fyret? Jo saktësisht.

Javët e dialogut në vitet 2012 dhe 2013 u përshpejtuan jo nga gatishmëria e të dyja palëve për ta pranuar njëra-tjetrën, për ta pranuar të kaluarën torturose dhe realitetin e raportit të tyre të ri, por më shumë nga arsytet politike: dëshira e përbashkët e Kosovës dhe Serbisë për anëtarësim në BE. Kjo dëshirë mund të përmbushej vetëm nga vetë BE-ja përmes nisjes së një procesi të trajtimit të njëri-tjetrit në mënyrë reale, me BE-në si ndërmjetësues të kërkesave dhe mospajtimeve të tyre. Shikuar nga këndvështrimi i BE-së, marrëveshja për dialog po bëhej thelbësore për vazhdimin e marrëdhënieve të saj me Prishtinën dhe Beogradin. Mosmarrëveshjet e vazhdueshme ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit lidhur me veriun e Kosovës (ku në korrik 2011 u vra një pjesëtar i policisë speciale të Kosovës në kuadër të një përpjekjeje të Prishtinës për të kthyer kontrollin në pikat kufitare dhe stacionet doganore në veri) bëri të qartë se veriun i dominuar nga serbët mbeti toka e askujt ku nuk funksionon as ligji i Kosovës, e as ai i Serbisë. Kjo rezultoi në rritjen e tensioneve dhe potencialit për konflikt kudo që Kosova përpikëj ta shtrijë kontrollin e saj, paralelisht me lulëzimin e krimet të organizuar

(një fushë ku bashkëpunimi ndërmjet serbëve e shqiptarëve nuk ka paraqitur kurrë ndonjë problem). BE-ja, që gjithmonë vepronte me ngadalë për marrjen e ndonjë veprimi vendimtar, nuk ishte më në gjendje të qëndronte anash duke shpresuar në progres.


Sot, dy vite e gjysmë që nga arritja e marrëveshjes, të gjitha palët (Kosova, Serbia dhe BE-ja) kanë përfituar nga ajo, pavarësisht ngecjeve. Mosbesimi ndërmjet të dyja palëve e bëjnë progresin e ngadalshëm dhe shpesh të dhimbshëm. Prishtina dhe Beogradi vazhdojnë të grinden duke akuzuar njëra-tjetrën për zvarritjen e marrëveshjes dhe për mospajtimin mbi detajet teknike duke gjetur, në ndërkohë, arsytetime për kryerjen e obligimeve të veta. Sidqoftë, mosmarrëveshjet kanë të bëjnë kryesisht me parimet e zbatimit, se sa me vetë mosmarrëveshjet. Megjithatë, është arritur përparim në aspektin e mbajtjes së suksesshme të zgjedhjeve lokale, integrimin e gjyqtarëve e prokurorëve serbë në sistemin juridik të Kosovës, zhbërjen e të ashtuquajturës Organizata për Mbrojtjen Civile në Veri dhe në marrëveshjet mbi energjinë dhe sigurimet e automjeteve. Më e rëndësishmja, marrëveshjet kanë bërë që konflikti të zhvendoset nga rrugët dhe fshatrat për në zyrat e Brukselit, ku pjesëmarrësve u kujtohet se duhet t'i zgjidhin qëndrimet e ndryshme në mes tyre nëse duan të përparojnë drejt BE-së. Në shkëmbim të kompromiseve të bëra, Serbia është shpërblyer me nënshkrimin e Marrëveshjes për Stabilizim Asociim (SAA) me BE-në, hapin e saj të parë në udhëtimin dejt BE-së.

Arritjet e tilla mund të mos duken arsye të forta për të festuar duke marrë parasysh tensionet e vazhdueshme ndërmjet dhe brenda të dyja palëve. Në situatën e ndezur politike në Kosovë, marrëveshja për krijimin e Asociacionit të Komunave me shumicë serbe shkaktoi së fundi protesta të dhunshme të organizuara nga partitë opozitare me pretendimin se asociacioni në fjalë do të ndante

Kosovën, ashtu siç kishte ndodhur në Bosnjë. Në këto protesta është injoruar fakti që për shkak të mbledhjeve të tilla populiste/nacionaliste minoriteti serb do të mund ta ndjejë edhe më shumë nevojën për mbrojtje shtesë. Ndërkaq, fushata e fundit e qeverisë serbe kundër anëtarësimit të Kosovës në UNESCO vështirëson procesin e normalizimit dhe injoron faktin që pjesa më e madhe e trashëgimisë kulturore serbe në Kosovë është ruajtur suksesshëm nga Policia e Kosovës për vite me radhë duke mos e përmendur përpjekjen kontradiktore për të arritur pikë politike me moslejimin e anëtarësimit të Kosovës në një organizatë ndërkombëtare e cila do ta obligonte Kosovën edhe më shumë që t'i mbrojë manastiret dhe kishat ortodokse serbe. Kundërthëniet, sado frustruese që janë, e bëjnë edhe më të qartë se marrëveshja e vitit 2013 nuk ishte fundi i procesit apo kulminimi i ndonjë arritjeje, por ka shënuar fillimin e një procesi që po vazhdon sot dhe që do të vazhdojë për një kohë të gjatë. Është e qartë se asnjëra nga palët nuk është e gatshme të merret me të kaluarën, por ato mund të përpiqen që të paktën përmes dialogut të detyrohen të merren me të tashmen. Tani për tani, kjo do të jetë e mjaftueshme.

- 1 | *Qeveria e Kosovës i sjell publikut raporte të rregullta mbi dialogun: <http://www.kryeministri-ks.net/?page=2,252>*
- 2 | *Qeveria e Serbisë sjell këto raporte këtu: <http://www.kim.gov.rs/pregovaracki-proces.php>*

Andreas Berg është konsulent e këshilltar i pavarur për çështje politike dhe të sigurisë. Ai ka punuar më herët si këshilltar për reformën e sigurisë në Qeverinë e Kosovës, si këshilltar politik i BE-së në Bruksel dhe si zyrtar politik/raportues për BE-në në Prishtinë. Ka prejardhje suedeze dhe amerikane. Ai ka diplomuar në Universitetin UC Berkeley në Kaliforni të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe në King's College të Londrës.



lajme dhe përditësime

Shkolla e Tretë Verore Ndërkombëtare në Sarajevë “Të mësosh nga e kaluara”

Kjo shkollë verore ndërkombëtare është shkolla e tretë e organizuar nga Departamenti i Marrëdhënieve Ndërkombëtare të IUS-it dhe këtë vit, është organizuar në bashkëpunim me Fakultetin Juridik dhe Qendrën për Mësim të Përjetshëm. Tema e këtij viti është “Të mësosh nga e kaluara-eksplorimi i rolit të drejtësisë tranzicionale në ndërtimin e besimit në shoqëritë pas konfliktit”.

Shkolla e parë verore e titulluar “Ndërkontinentale - marrëdhëniet ndëretnike për paqe” (NMNP) dhe shkolla e dytë verore e titulluar “Të mësosh nga e kaluara: 20 vite pas Luftës së Bosnjes - edukimi për pajtim dhe paqe të qëndrueshme në shoqëritë pas konfliktit” u vlerësuan shumë lart për fushëveprimin, qasjen ndërdisiplinore dhe pedagogjisë inovative që përfshinte të mësuarit ndërkulturor dhe të mbështetur në përvojë dhe veprim. Si me shkollat verore të mëparshme, ligjëruesit e shquar, të njohur botërisht në fushat e tyre, do të fasilitojnë të mësuarit aktiv të studentëve duke i përfshirë ata në procesin e mësimin në të gjitha fazat, edhe në aktivitetet interaktive të mësimin, diskutimet në klasë, vizita në terren dhe mësimin përmes veprimit në kontekstin e komunitetit lokal.

Afati i fundit për regjistrim (për nivelin e argjendte dhe të artë): 03/06/2016

Afati i fundit për regjistrim (për nivelin lokal): 10/06/2016

Kohëzgjatja e shkollës verore: 20/06/2016 - 04/07/2016

Faqja në internet: <http://lftp.ius.edu.ba>

botimi i radhës

Botimi Nr. 5 i Balkan.Perspectives do të shtjellojë temën e gjinisë, marrëdhënieve gjinore dhe pse është e rëndësishme që ato të merren parasysh kur bëhet fjalë për proceset e ndërlidhura me ballafaqimin me të kaluarën. Ne do të shohim se si janë marrëdhëniet gjinore në shtetet e ndryshme të Ballkanit Perëndimor për të kuptuar se sa kanë ecur sa i përket pranimit të gjinive të ndryshme gjatë procesit të ballafaqimit me të kaluarën.

Impressum

Balkan.Perspectives publikohet nga *forumZFD*.

Forumi i Shërbimit Civil Paqësor (*forumZFD* - Forum Ziviler Friedensdienst), është organizatë gjermane e themeluar në vitin 1996. Organizata *forumZFD* trajnon dhe angazhon ekspertë të paqes në rajonet e konfliktit që të bashkëpunojnë me partnerët vendorë për të promovuar bashkëjetesën paqësore dhe zgjidhjen paqësore të konflikteve. Partneri i saj strategjik për Ballkanin Perëndimor është *pax christi* në dioqezën e Aachen.

Në Ballkanin Perëndimor, fokusi është tek fusha e ballafaqimit me të kaluarën dhe tek nxitja e dialogut ndërmjet palëve të kundërta. Këtu përfshihen projektet e ndërmjetësimit në shkolla, mbështetja për shoqëri të civilë ose zhvillimi i kapacitetit të medias për një qasje më konstruktive ndaj ballafaqimit me të kaluarën.

Ky program financohet nga Ministria Federale për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik e Gjermanisë (BMZ).

KRYEREDAKTORE:

Maike Dafeld

EKIPI REDAKTUES:

Sunita Dautbegović-Bošnjaković, Vjollca Islami Hajrullahu, Nora Maliqi, Johannes Rueger, Nehari Sharri

AUTORË:

Andreas Berg, Mefaül Ismaili, Julijana Mojsilović, Nerkez Opaçin, Vildana Selimbegović, Adis Susnjar, Maja Vaseva

FAQOSJA:

Kokrra

SHTYPI:

Envinion

PËRKTHIMI:

Merita Fejza (shqip), Bjanka Osmanović (serbo-kroatisht), Reis Kjerim (maqedonisht)

KORREKTURA GJUHËSORE:

LBG Communications (shqip), Silvana Krzouska (maqedonisht), Zinaida Lakiq (serbo-kroatisht), Jack Robinson (English)

KONTAKTI:

Balkan.perspectives@forumzfd.de

VENDI I PUBLIKIMIT:

Këln, Gjermani

Forumi i Shërbimit Civil Paqësor | Forum Ziviler Friedensdienst e. V. (*forumZFD*)

Zyra në Kosovë: Pejton. Sejdi Kryeziu 16. 10000 Prishtinë	Zyra në Serbi: Prote Mateje 17 11000 Beograd
---	--

Zyra në Bosnjë e Hercegovinë: Branilaca Sarajeva 19B 71000 Sarajevë	Zyra në Maqedoni: Borka Taleski 11/4 1000 Shkup
---	---

Mohim i përgjegjësive

Balkan.Perspectives synon të nxisë debate mbi ballafaqimin me të kaluarën në Ballkan. Pikëpamjet e paraqitura në këtë revistë janë ato të kontribuesve dhe nuk pasqyrojnë detyrimisht pikëpamjet e redaktorit apo të *forumZFD*. Botuesit i kanë kontrolluar me kujdes lidhjet e internetit të promovuara në këtë revistë periodike, por ata nuk mund të mbahen përgjegjës për përmbajtjen e faqeve të jashtme të internetit.

Jeni të mirëseardhur ta kopjoni dhe rishpërndani këtë material, qoftë në formë të shtypur apo elektronike, por vetëm nëse nuk e ndryshoni tekstin, nëse citoni burimin dhe nëse nuk kërkonit të holla në këmbim të kopjes.

